



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 878/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit, LLM 60 me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit, LLM 60	Adelina Rakaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


- Për programin e studimit; *Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit, LLM 60* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: "Peter Parycek, Johannes Falterbaum dhe Horia Onita është organizuar më 08.02.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht dy (2) ndërsa Pjesërisht pesë (5) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Dazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë